



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 3701/1 Prishtinë 28.10. 2022

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti Mazllum Kamberi ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: " Analiza Pushover e sistemeve Ram nga betoni i Armuar " në programin e studimeve Master Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

Abstrakt

Për të modeluar sjelljen komplekse të betonit të armuar në menyrë analitike në zonën e tij jolineare është tejet e vështirë. Kjo ka bërë që inxhinierët në të kaluarën të mbështeteshin shumë në formulat empirike të cilat kanë rezultuar nga eksperimentet e shumta për projektimin e strukturave nga betoni i armuar.

Për projektimin e strukturave dhe vlerësimin e pjesëve të strukturës nga betoni i armuar, analiza jolineare është bërë tejet e rëndësishme. Kjo analizë mund të përdoret për të studiuar sjelljen e strukturave të betonit të armuar duke përfshirë rishpërndarjen e forcës.

Kjo analizë e sjelljes jolineare të strukturave nga betoni i armuar ndihmon në vlerësimin e sjelljes së strukturës nën veprimin e ngarkesave të ndryshme ,devijimin e ngarkesës dhe modelin e plasaritjeve.

Në këtë punim sjellja jo-lineare e ramit nga betoni i armuar duke përdorur softwerin ETABS ku janë aplikuar ngarkesat e supozuara është kryer me synimin për të vlerësuar rëndësinë relative të disa faktorëve në analizën jolineare të ramave nga betoni i armuar.

Fjalët kyçe: analiza pushover, sjellja jo-lineare, projektimi sizmik, kurba e kapacitetit, procedurat jo-lineare statike, inxhinieria sizmike bazuar në performancë, kërkesat e performancës dhe kriteret e pranueshmërisë, vlerësimi sizmik, rrjedhja e çelikut, thyerja e betonit, plasticiteti, zhvendosjet target.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.